

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime****PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)***OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Mirembajtje dhe riparim automjesh”**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Shërbime riparimi për automjete 50112110-7

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 6 105 167 ( gjashtë milion e njëqind e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)lekë pa TVSH dhe 7 326 200 (shtatë milion e treqind e njëzet e gjashtë mijë e dyind ) lekë me tvsh:

Nr.	Fondi limit ne leke pa tvsh	Fondi limit ne leke me tvsh
Administrata	1 166 667	1 400 000
Spektori i menaxhimit te mbetjeve	1 875 000	2 250 000
Spektori i Sherbimeve publike	583 333	700 000
Zjarrefikeset	1 298 250	1 557 900
Spektori i Rrugeve Rurale	750 083	900 100
Drejtoria e Administrimit te Pyjeve	431 833	518 200
<b>TOTALI</b>	<b>6 105 167</b>	<b>7 326 200</b>

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madhe, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertës dhe listën e cmimeve të artikujve sipas shtojcave 1 dhe 2.*

*\*Shenim: Ne Oferten e tij, OE pjesemarrës ne procedure duhet te respektoje fondin limit te cdo sektori, duke mos e tejkaluar ate. Paraqitja e ofertes ne kundershtim me kete pike perben shkak per skualifim.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 - 2024 - 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2023 - 2024 - 2025) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që te tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit. Shenim: Ne respektojmë te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

#### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

- 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 3 (tre) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- 1 (një) motorrist
- 1 (një) mekanik
- 1 (një) elektroauto

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër, duhet të paraqesë kontratat individuale të punës, dhe dëshminë e kualifikimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërve, të sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj është e nevojshme pasja e një stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, e vertetuar kjo në baze të kontratave të punës si dhe të deklaratës së plotësuar nga operatori ekonomik me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.3. Ofertuesi duhet të paraqesë dokumenta që provon se posedon servis jo më larg se 30 km nga Bashkia Malesi e Madhe.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin të objektit të prokurimit dhe ky ambjent duhet të jete në një distancë të arsyeshme nga vendqendrimi i mjeteve të Bashkisë me qëllim minimizimin e kostos kohore dhe ekonomike të transportit.

2.3.4. Dëshmi për makinerite dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte (ne pronesi ose me qira):

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Karrotrec	1 copë	Në pronësi ose me qera

Per kete, OE duhet te paraqese Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekti i kësaj kontrate është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, nder te cilat mund te ndodh qe ne raste te caktuara duhet të transportojnë nje automjet te difektuar ne ambientet e servisit qe disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht karrotrec me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

2.3.5. Ofertuesi duhet te deklaroje se Garancia per pjeset e kembimit qe do te perdoren gjate riparimit te automjeteve do te jete jo më pak se 6 muaj nga data e daljes se mjetit nga riparimi.

**Argumentimi:** Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi një vit garanci dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate qe ofron sherbimin e kerkuar ne kete procedure edhe ne terren ne rast te nevojave te autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Me anë të kësaj deklarate synohet që ne rast se AK-se do t’i lind nevoja per riparime ne terren te hapur, ne vende ku makineria qe mund te pesoje defekt, eshte duke kryer funksionet perkatese, OE do te jete i gatshem te kryeje sherbimin ne vend, nese kjo eshte e mundur pa e transportuar ne servis.

2.3.7.Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate qe merr persiper transportin (pa kosto shtese) me karrotrec te mjeteve objekt riparimi ne rastet kur AK e ka te nevojshem nje sherbim te tille.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Me anë të kësaj deklarate synohet që në rast se AK-se do t'i lind nevoja për transportuar mjetet që nuk janë në gjendje të mbërrijnë deri në servis për shkak të dëmtimeve mekanike ose të ngjashme, kontraktori të sigurojë shërbimin e transportit me karrotrec në mënyrë që të mos pengohet riparimi në kohë të automjeteve.